

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Tonka Berishaj dhe Fillim Skoro, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesionalë, Syzana Goxhuli, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit: H.S., nga fshati ..., K. Prishtinë, për shkak të veprës penale- blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK, duke vendosur lidhur me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit H.S., av. N.S., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.247/17 të datës 09.08.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, me datën 25.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit H.S., av. N.S., kurse aktgjykimi të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.247/17 të datës 09.08.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin PKR.nr.247/17 të datës 09.08.2017, të akuzuarin H.S., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale- blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK, dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet dhe dënim me gjobë në shumë prej 3800 €, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi ta marr formën e prerë. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën e shqiptuar atëherë gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim burgimi duke llogaritur një (1) ditë burgim për çdo 20 € të gjobës së shqiptuar.

Ndaj të akuzuarit është shqiptuar dhe dënimi plotësues-konfiskimi i përhershëm i sendeve: automjeti Golf V, tip 1K, me nr. të regjistrimit 02-387-CO, si dhe narkotiku i llojit marihuan në sasi prej 6601 gram, si objekt i veprës penale, kurse telefoni celular i është kthyer .

I akuzuari është obliguar që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 100 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit pas shpalljes së aktgjykimit i është ndërprerë masa e paraburgimit, ndërsa koha e kaluar në paraburgim prej dt. 12.05.2017 deri me 09.08.2017 i është llogaritur në dënimin e shqiptuar me burgim.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit H.S., av.N.S., për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë përkitazi me vendimin mbi dënimin dhe të akuzuarit për veprat për të cilat është shpallur fajtorë të i shqiptohet dënim më të ultë ose dënim të kushtëzuar.

Prokurori i Shtetit, me parashtrësën PPA/I.nr.432/17 të datës 102.10.2017, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit të refuzohet si e pabazuara, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e caktoi konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, në të cilën ishte i pranishëm mbrojtësi i të akuzuarit, av. N.S., i cili pasi që bëri disa sqarime përkitazi me pretendimet ankimore, mbeti pran ankesës së ushtruar dhe i akuzuari H.S., i cili e mbështeti ankesën e mbrojtësit të tij. Prokurori i Apelit, edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt, nuk mori pjesë në seancën e kolegjit, andaj seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPK-së, në mungesë të tij.

Gjykata e Apelit pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimit ankimorë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Meqë aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, atëherë Gjykata e Apelit të njëjtin e vlerësoi në pajtim me dispozitën e nenit 394 par 1 të KPPK-së, sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit që kishin me kushtëzuar prishjen e tij.

Po ashtu gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, pasi që nuk lejohet ankesa për këtë bazë ankimore sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe me këtë është pajtuar trupi gjykues, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimit ankimor.

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë. Në ankesë theksohet se gjykata e shkallës së

parë, me rastin e matjes së dënimit edhe pse i ka konstatuar disa rrethana lehtësuese të njëjtat i ka nënvlerësua sepse po të kishte bërë vlerësimin e drejtë konform dispozitave ligjore për matjen e dënimit ka pasur mundësi dhe është dashtë që të shqiptoi një dënim më të ulët me burgim dhe gjobë ose dënim të kushtëzuar. Në ankesë po ashtu theksohet se i akuzuari që në fillim të ndjekjes penale e ka pranuar fajësinë, ka shpreh pendim dhe ka premtuar se nuk do të kryej vepra tjera penale, prandaj gjykata e shkallës së parë në rastin konkret është dashtë që të aplikojë dispozitat për zbutje të dënimit nën minimum ligjor konform nenit 76 të KPRK.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, të akuzuarit i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese: pendim dhe keqardhjen për veprën e kryer penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme dhe pranimin e fajësisë si rrethanë posaçërisht lehtësuese, ndërsa rrethana renduese nuk gjeti.

Vlerësimin e këtillë të rrethanave për matjen e dënimit, si të drejtë e aprovon edhe Gjykata e Apelit, e cila vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe është në funksion të preventivës së përgjithshme, posaçërisht asaj të posaçme dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPK-së. Për një dënim më të butë, siç pretendon mbrojtja, nuk janë plotësuar kushtet ligjore, aq më parë kur me ankesa nuk theksohen rrethana të tilla që do të arsyetonin një dënim më të butë.

Nga çka u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.456/2017 me date 25 tetor2017

Procesmbajtës,

Anëtarët e kolegjit,

Kryetari i kolegjit,

Syzana Goxhuli

Tonka Berishaj_____

Xhevdet Abazi

Fillim Skoro_____